

STATISTIKAT E KRIMEVE DHE DREJTËSISË PENALE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
4. Njësia matëse	6
5. Periudha e referencës	6
6. Mandati institucional.....	6
7. Konfidencialiteti	7
8. Politika e botimit.....	8
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	8
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	8
11. Menaxhimi i cilësisë	9
12. Rëndësia.....	9
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	10
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	10
15. Kohërendja dhe Krahueshmëria.....	11
16. Kostoja dhe ngarkesa	12
17. Rishikimi i të dhënave.....	12
18. Përpunimi statistikor	12
19. Komentet.....	14
Aneks	14

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Deana Delaj
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rruga Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	ddelaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	30.04.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	30.04.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	30.04.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Veprat penale, të dëmtuar dhe autorë: INSTAT mbledh, analizon dhe publikon të dhëna mbi veprat penale, autorë dhe persona të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale. Statistikat mbi veprat penale bëjnë fjalë për vepra specifike të regjistruara nga policia, klasifikimi i të cilave bëhet duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Veprat e regjistruara janë ngjarje të evidentuara, jo gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë verdiktin. Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Ato përfshijnë të dhëna mbi autorët për vepra penale specifike dhe për totalin e gjithë veprave të regjistruara sipas gjinisë, grupmoshës, etj. Një rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet jo vetëm evidentimit të veprave penale, luftës në kapjen e autorëve, por edhe mbrojtjes së pozitës së personit të dëmtuar nga kryerja e veprës penale. Të dhënat mbi të dëmtuarit përfshijnë të dhëna mbi veprat specifike dhe të dëmtuarit sipas gjinisë, grupmoshës.

	Statistikat mbi personat e pandehur dhe procedimet penale: Statistikat mbi procedimet penale dhe personat e pandehur pasqyrojnë të dhëna nga Prokuroria e Përgjithshme. Të pandehurit paraqesin të dhëna për personat të cilëve ju është njoftuar akuza për veprën penale dhe janë të disagreguara sipas gjinisë, grupmoshës dhe veprave penale. Të dhënat nga prokuroria pasqyrojnë statistika mbi procedimet penale dhe të pandehur sipas vepra penale, klasifikim bazuar në Kodin Penal. Statistika mbi të dënuarit: Statistikat mbi të dënuarit pasqyrojnë numrin e individëve ndaj të cilëve janë aplikuar sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale. Sanksione këto që konsistojnë në dënime me burg, gjobë ose dënime alternative. Dënimet alternative mund të jenë gjysmëliria, punë në interes publik, pezullimi dhe qëndrimi në shtëpi. Të dhënat statistikore mbi të dënuarit përfshijnë: numrin e të dënuarve sipas gjinisë dhe grupmoshës, të dënuarit sipas llojit të veprës së kryer, dhe numrin e të dënuarve sipas gjinisë. Statistika mbi të burgosurit: Statistikat mbi të burgosurit përfshijnë personat e mitur (nën 18 vjeç), të rritur (mbi 18 vjeç) sipas gjinisë të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë si edhe të paraburgosurit ndër vite. Numri i të burgosurve tregon gjendjen e të burgosurve në një vit të caktuar duke përfshirë hyrjet e reja dhe daljet që ndodhin për periudhën në fjalë. Të dhënat mbi të burgosurit përfshijnë statistika mbi numrin e të burgosurve, paraburgosurve sipas gjinisë dhe veprës së kryer. Gjithashtu, gjenerohen edhe të dhëna për të miturit, femrat, aktivitetet rehabilituese në burgje etj. Treguesit e krimeve: Këta tregues llogariten mbi të dhënat e ardhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe përllogaritjet vjetore të popullsisë banuese nga INSTAT.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale bazohen në klasifikimin e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë .
3.3. Mbulimi i sektorit	Të dhënat mbulojnë faza të ndryshme të sistemit të drejtësisë: raportimi në polici, prokurori, gjykata dhe burgje.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Vepra penale: Sjelle, veprime apo mosveprime me të cilat cënohen, dëmtohen vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar quhen vepra penale apo me një term të përgjithshëm kriminalitet. Ato ndahen në krime dhe kundërvajtje penale. Kundërvajtje penale: Kundërvajtjet paraqesin vepra të tilla me të cilat cënohen apo dëmtohen të mirat juridike me vlerë më të vogël krahasuar me veprat penale. Pra, çënojnë rendin juridik por nuk prekin bazat e tij dhe nuk kanë pasoja të rënda shoqërore.

Vepra penale të raportuara: Vepra të raportuara në polici ose mbi të cilat policia ka njohuri mbi to në mënyra të tjera.

Krime kundër personit: Kuptohen ato vepra (veprime ose mosveprime) të kundërligjshme, të kryera me dashje ose nga pakujdesia, të cilat prekin ose vënë në rrezik jetën, shëndetin, liritë, paprekshmërinë seksuale, nderin e dinjitetin e personit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.

Krime kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike: Përfshihen vjedhje pasurie, mashtrime, krime në fushën e doganave, tatim-taksave, shkatërrimi i pronës, krime që çenojnë regjimin juridik të tokës etj.

Vrasje me dashje: Vepër i kundërligjshëm, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përfshihen veprat penale si: Neni 76 vrasje me dashje, Neni 77 vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 vrasje me paramendim, Neni 78/a vrasje për gjakmarrje, Neni 79 vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c vrasje për shkak të mardhënieve familjare, Neni 81 vrasje e foshnjës.

Krime seksuale: Marrëdhëniet juridike të vendosura në sferën e sigurisë së lirisë seksuale dhe të zhvillimit normal të formimit seksual, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal. Përfshihen nenet 100- 108/a të Kodit Penal.

Krime me dashje kundër shëndetit përfshihen neni 86 Tortura, neni 87 Tortura me pasoja të rënda, neni 88 Plagosje e rëndë me dashje, neni 89 Plagosje e lehtë me dashje, neni 89/a Shitblerje transplantesh dhe neni 90 Dëmtime të tjera me dashje.

Mashtrim: Kuptohet marrja ose hedhja në dorë me anë të gënjeshtërsisë ose të shpërdorimit të betimit të pasurisë apo të të drejtave pasurore të personit fizik, personit juridik ose të shtetit, me qëllim të përfitimit material për vete ose për të tjerët. Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

Krime në fushën e drogës: Përfshijnë veprat si prodhimi, kultivimi, shitja e lëndëve narkotike dhe trafikimi i tyre. Përfshihen veprat penale si: neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

Falsifikim monedhash përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor përfshihet veprat penale si: neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi si edhe neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.

Dhuna në familje: Përfshihen ato akte si rrahja, apo vepër tjetër dhune, kanosje serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij. Neni 130/a i Kodit penal.

Trafikimi i armëve: Përfshihen nenet 278-280 të Kodit Penal.

Krimi kibernetik: Përdorimi i një kompjuteri si instrument për qëllime të mëtejshme të paligjshme. Përfshihen veprat penale si: 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik, 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik, 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik,

	186/a Falsifikimi kompjuterik, 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterike, 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike, 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike, 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike, 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve. Pastrim i produkteve të veprës penale: Përfshihen nenet 287 Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, 287/a Çelja e llogarive anonime, 287/b Pëvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale. Përndjekja: Përfshihet neni 121/a i Kodit Penal. Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror: Përfshihet neni 297 i Kodit Penal. Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit: Përfshihet neni 298 i Kodit Penal. Autorë: Person i cili me veprimin ose mosveprimin e tij lejon që të ndodh një vepër penale, pra shkakton pasojën e veprës penale. Autorët mbi 14 vjeç kanë përgjegjësi penale, ndërkohë fëmijët nën 14 vjeç janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale. I dëmtuar: Personi të cilit çfarëdo e drejtë personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale. I mitur: Është çdo person nën 18 vjeç. I dënuar: Personi i cili me veprat apo sjelljet e tij ka cënuar apo ka dëmtuar të mirat juridike që mbrohen me ligj. Ndaj këtyre personave aplikohen sanksione penale të cilat konsistojnë në marrjen apo kufizimin e disa të drejtave të cilat i kanë gëzuar deri në momentin e kryerjes së veprës penale. Numri i të burgosurve: Numri gjithsej i të burgosurve tregon numrin e personave të mbajtur në ambientet e burgjeve, institucione të tjera, institucionet e burgosjes së të miturve, spitalet psikiatrike ose spitale të tjera. Përfshijnë si të dënuarit me burg dhe të paraburgosurit deri në 31 Dhjetor të çdo viti. I dënuar me burg çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale. I paraburgosur: Përfshihen personat, shtetas shqiptar, të huaj apo pa shtetësi, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”. Koeficienti i kriminalitetit: Numri i veprave penale të evidentuara për 10 mijë banorë në një vit të dhënë. Norma e të burgosurve shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në burgje në privim lirie ndaj popullsisë rezidente për 10 mijë banorë, në një vit të dhënë. Të paraburgosur në privim lirie shpreh numrin e përgjithshëm të personave të mbajtur në paraburgim që ende nuk janë dënuar, si përqindje ndaj numrit të përgjithshëm të personave të mbajtur në burgje në një vit të dhënë.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e të dhënave është vepra penale, autorë, të pandehur, të dënuar dhe të burgosur.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet: veprave penale të regjistruara nga policia,

	numrit të personave të dyshuar në kryerjen e një veprë, numrit të personave të dëmtuar nga vepra penale, numrit të personave të pandehur, të dënuar, të paraburgosur dhe të burgosur. Gjithashtu numrit të personelit që punojnë në role specifike në sistemin e drejtësisë, numrit të çështjeve të trajtuara nga gjykatat.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e agreguara janë në nivel qarku dhe vendi.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2010 dhe në vazhdim për: • Veprat penale; • Autorë; • Të dëmtuar • Persona të dënuar; • Të burgosur. Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2015 dhe në vazhdim për: • Procedime penale; • Të pandehur
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Në statistikat e krimeve dhe drejtësisë përdoren njësi të ndryshme matëse. Njësia bazë statistikore në statistikat e krimeve është vepra penale dhe çështjet. Njësia matëse për viktimat e veprave penale, autorë, të pandehur, të dënuar, të paraburgosur dhe të burgosur, personelin në sistemin e drejtësisë është individi.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Ky raport i referohet vitit 2024.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, Statistikat e krimeve janë bazuar në: • Ligj nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare; • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Memorandum me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë; • Memorandum me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve; • Memorandum me Prokurorinë e Përgjithshme; • Memorandum me Ministrinë e Drejtësisë.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	INSTAT transmeton të dhëna mbi krimet dhe drejtësinë penale në Eurostat në pyetësor, si pyetësori UN-CTS (të dhëna mbi krimet dhe drejtësinë penale),

	pyetësi Regional Crime (të dhëna rajonale mbi krimet dhe drejtësinë penale) dhe pyetësi mbi hyrjet e paligjshme të kufirit. INSTAT transmeton të dhëna për Eurostat në lidhje me krimet dhe statistikat juridike nëpërmjet një koleksioni të përbashkët të të dhënave të Eurostat-UNODC, çdo vit në shtator. Pyetësi i UNODC përfshin 8 fletë për t'u plotësuar dhe plotësohet nga pyetësi i Eurostat-it. Pyetësi i Eurostat përbëhet nga 1 fletë që përmban pyetje të kërkuara nga Komisioni Evropian për fushat e tij specifike të politikave. Pyetësi përmban të dhëna për veprat penale të regjistruara, autorët, viktimat e vrasjeve, të dhënat mbi ndjekjen penale, të burgosurit, personat e dënuar dhe të pafajshëm.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktuara shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësive statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesa janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendar i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”, statistikave zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individ, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë: • Website – online release; • Kërkesat e shkruara; • Publikimi; • Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshhtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshhtësia e shpërndarjes	Shpërndarja e të dhënave të krimeve dhe drejtësisë penale bëhet në baza vjetore përmes botimeve të përmendura më lart.
10. Akses i të dhënave dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale. Njoftimi për shtyp i Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Publikime për Statistikat e Krimeve dhe Drejtësisë Penale: Vjetore: • Burra dhe Gra; • Shqipëria në shifra; • Vjetari statistikor; • Vjetari statistikor rajonal. Botim i dedikuar: • Statistikat e krimeve dhe drejtësia penale.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht.

	Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni më poshtë: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Nuk aplikohet.
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet këtij seksioni të dedikuar për kërkesë të dhënash .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Të dhënat janë siguruar nga burime administrative në vend si Drejtoria e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Një shpjegim i shkurtër rreth përkufizimeve dhe metodologjisë për statistikën e krimeve i vihet në dispozicion përdoruesve në fund të publikimeve si dhe në temën Krimet dhe Drejtësia Penale. Informacione të tjera shpesh ju ofrohen përdoruesve të brendshëm nëse kërkohen.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale dokumenton të gjithë proceset dhe procedurat e punës për përdorim të brendshëm.
11. Menaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin Për Statistikat Zyrtare Nr. 17/2018 , INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënave për statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm. - Përdoruesit e jashtëm janë: - Institucionet e Administratës Publike; - Universitetet; - Bizneset;

	- Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit; - Organizata kombëtare jofitimprurëse; - Disa tregues kryesorë dërgohen në Eurostat, UNODC. 2. Përdoruesit e brendshëm janë brenda INSTAT të cilët përdorin statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale si input për punën e tyre. Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të krimeve dhe drejtësisë penale është siguri i një informacioni më të plotë për shkak të rëndësisë sociale që mbartin këto statistika si dhe për shqetësimet e publikut lidhur me to.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për Matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve, rezultatet e të cilit publikohen në web në linkun: Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vërtetimit për 2024 tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës "Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale" është vlerësuar me 3.84 (76.8 %) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	INSTAT transmeton në Eurostat pyetësor për statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale. Qëllimi kryesor është të arrihet një plotshmëri më e madhe e treguesve të këtyre pyetësorëve, të cilët përfshijnë edhe tregues jo kryesor (rotating) të cilët ndryshojnë sipas periudhës referuese.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënave për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigjimi i këtyre të dhënave nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet.
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 120 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 120 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale është 31 Dhjetori 2024.

	Periudha referuese	12/31/2024
	Data e publikimit	4/30/2025
	Afatet kohore	120
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve.	
	Periudha referuese	12/31/2024
	Data e shpallur	4/30/2025
	Data e publikimit	4/30/2025
	Vonesa në kohë	0
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria		
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale në disa botime paraqiten në nivel qarku ku përfshihen: Berat; Dibër; Durrës; Elbasan; Fier; Gjirokastrë; Korçë; Kukës; Lezhë Shkodër; Tiranë; Vlorë. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënave. Në të kundërt, dihet se statistikat e krimit në nivel ndërkombëtar kanë krahasueshmëri të ulët për shkak të rregullave të ndryshme të numërimit, legjislacioneve, rregullave të regjistrimit, etj. Puna për të përmirësuar krahasueshmërinë është në vazhdim. Lidhur me Klasifikimin Ndërkombëtar të Krimit për Qëllime Statistikore (ICCS), zbatimi është pezulluar për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme në Kodin Penal të Shqipërisë, të cilat ndikojnë në proceset që lidhen me hartëzimin e ICCS. Pavarësisht këtij ngërçi, ne ende kategorizojmë dhe përshtasim veprat penale (duke mos përfshirë veprat penale me përputhje të pjesshme) sipas pyetësorit ICCS për UN-CTS.	
15.2. Krahasueshmëria kohore	Statistikat e krimeve datojnë që nga viti 1993. Procedurat statistikore për regjistrimin e veprave kanë ndryshuar në disa raste, për shembull nëpërmjet mbledhjes së re ose metodave të reja të numërimit. Ndërkohë ngjarjet individuale mund të ndikojnë përkohësisht në statistikat për disa vite. Këto ndryshime janë të rëndësishme për të kuptuar veprat e raportuara me kalimin e kohës. Për shembull, në vitin 2015, Policia zbatoi një sistem të ri për menaxhimin e çështjeve. Nga ky vit, të dhënat janë më të sakta dhe kemi një numër më të madh të veprave të regjistruara. Statistikat e Krimeve ofrohen çdo vit dhe janë të krahasueshme mes tyre. Seria kohore për treguesin “Vepra penale të evidentuara” ekziston nga viti 2015, duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 10 vitesh. (CC2=Jlast-Jfirst+1=10). Të dhënave ju bëhen kontrole të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.	
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Klasifikimi i veprave penale në krime dhe kundërvajtje penale bëhet bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Këto vepra të regjistruara bëjnë fjalë për ngjarje të ndodhura, të regjistruara nga policia, jo për gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë vendimin.	

15.4. Koherenca e brendshme	Koherenca e brendshme e të dhënave kontrollohet me rregullat e validimit të shumës, si shuma e nëntotalit, ndryshimet e mëdha ndër vite, ndryshime të mëdha, siç përmendet në raport. INSTAT mbledh të dhëna për Dhunën në Familje. Ofruesi kryesor I këtyre të dhënave është Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila na furnizon me të dhëna mbi rastet e raportuara të dhunës në familje, autorët dhe numrin e kërkesave për urdhër mbrojtje. Të dhënat për gjininë dhe grupmoshat janë për autorët dhe të dëmtuarit nga veprat penale.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale është pjesë e Drejtorisë së Statistikave Sociale. Sektori ka 1 specialist i cili merret me statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e revizionimit; • Politika e trajtimit të gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi “Statistikat e Krimeve dhe Drejtësisë Penale” do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e ardhshëm shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi “Statistikave të Krimeve dhe Drejtësisë Penale” për vitin 2024, subjekti i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Të dhënat bazohen në burime administrative. Ofruesit kryesorë janë: • Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; • Prokuroria e Përgjithshme; • Ministria e Drejtësisë; • Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Bazuar në këto burime, INSTAT mbledh, analizon, klasifikon dhe publikon të dhëna në lidhje me krimet dhe statistikat juridike. Të dhënat shprehen si numër dhe si tregues.

18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë janë vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Në bazë të Memorandumit të Mirëkuptimit midis 2 institucioneve, INSTAT siguron të dhëna më të detajuara për kriminalitetin, të gjithë veprat penale të parashikuara sipas kodit penal dhe të cilat janë evidentuar nga policia. Gjithashtu të dhëna për personat e dëmtuar sipas veprave penale, gjinisë dhe grupmoshës. Të dhënat mbi autorët përfshijnë të dhëna sipas veprave, lidhjes viktimë-autorë, grupmoshës së autorit, shtetas i huaj ose jo, masave të sigurimit, nivelit arsimor. INSTAT siguron nga Prokuroria e Përgjithshme të dhëna mbi procedimet penale të regjistruara dhe dërguar për gjykim për të gjitha veprat penale të parashikuara në Kod penal, gjithashtu të dhëna për të pandehurit sipas gjinisë dhe 2 ndarjeve moshore sipas veprave penale. INSTAT publikon të dhëna mbi personat e pandehur dhe procedimet penale sipas veprave penale specifike. Në lidhje me të dhëna shtesë që kërkohen në pyetësonin e Eurostat, tabela të përgatitura dërgohen në formë shkresore pranë Prokurorisë. Një burim tjetër i të dhënave është dhe Ministria e Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë publikon çdo vit një Vjetar Statistikor dhe INSTAT-i bazohet në këtë botim për të dhënë statistika mbi personat e dënuar, llojin e veprave penale, rastet e trajtuara sipas nivelit të gjykatave. Nga Gjykata e Lartë merret në formë shkresore një evidencë statistikore mbi rastet (penale, civile dhe administrative) të trajtuara prej saj nga secila gjykatë e qarkut. Kjo evidencë përmban statistika mbi çështjet, mënyrën e përfundimit të tyre dhe afatet e kohëzgjatjes së çështjeve. Për të dhëna shtesë, në varësi të kërkesave specifike të përdoruesve, INSTAT i drejtohet me shkresë zyrtare ministrisë. Të dhënat e lidhura me të burgosurit sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me periodicitet vjetor. INSTAT publikon të dhëna për të burgosurit të ndara sipas gjinisë, nivelit të arsimit, dy grupmoshave kryesore (të mitur nën 18 vjeç dhe të rritur mbi 18 vjeç) dhe sipas llojit të krimeve që janë dënuar. Informacioni merret nga formatet statistikore që burgjet kanë, i siguruar nga MoU midis 2 institucioneve. Në çdo IEVP ekziston një dokument i quajtur Komunikim ditor që plotësohet nga personeli i burgut, dokument ky, i cili përmban informacione për secilin person të burgosur. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve mbledh këto të dhëna dhe siguron informacion për të burgosurit çdo tremujor. Këto burime janë shumë të rëndësishme për ecurinë e punës dhe për plotësimin e afateve të përcaktuara kohore, sepse INSTAT-i nuk realizon vrojtimit për statistikat e krimeve.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Me metoda të verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: kontrollin për plotësinë e të dhënave, konsistencën me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrollin e serive kohore nëse ka devijime të mëdha etj. Para se të dhënat të publikohen, INSTAT kontrollon nëse ka ndryshime në trend ose llogaritje të gabuara, të dhënat rishikohen. Duke qenë se të dhënat mblidhen manualisht, ka mundësi gabimesh. Gjithashtu, INSTAT-i rishikon vlefshmërinë e të dhënave kur transmeton të

	dhënat e pyetësorit nëpërmjet sistemit elektronik të të dhënave dhe administratës së informacionit të Eurostat (eDAMIS).
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	